



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

7828 16.05.2022

N J O F T I M

Për keshillim me publikun

Pranë këshillit bashkiak Shkodër është paraqitur për miratim projektvendimi “Për një ndryshim në VKB nr.22, datë 18.4.2019 për miratimin e “Planit lokal për veprimin e zhurmës në mjedis të Bashkisë Shkodër.

Sa sipër, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, këshilli bashkiak Shkodër, njofton konsultimin me publikun në lidhje me këtë dokument.

Sugjerimet, komentet, mund të dërgohen deri me datë 10.6.2022, me shkrim pranë Bashkisë Shkodër, me postë, apo nëpërmjet email në adresën:
keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

Bashkëlidhur projektvendimi për konsultim

Duke ju falenderuar

Sekretar i këshillit

Denis Lesha



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI**

Nr. 5879 Prot

Shkodër, më 14 04 .2022

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendim dhe relacion.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim relacionin materialin bashkëlidhur dhe projekt-vendim:

“Për një ndryshim në vkb nr. 22, date 18.04.2019 për miratimin e “Planit lokal për veprimin e zhurmës në mjedis” të Bashkisë Shkodër”

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt !


KRYETAR
Bardh SPAHIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr _____ prot

Datë ____/____/2022

PROJEKT VENDIM

NR. _____, DATË _____.____.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 22, DATE 18.04.2019 PËR MIRATIMIN E
“PLANIT LOKAL PËR VEPRIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS” TË BASHKISË
SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____.____.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur nenin 26 pika 2, nenin 54 shkronja “k” e ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar;nenit 22 të ligjit nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”i ndryshuar;neni 8 i ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar;VKM nr.123,datë 17.02.2011 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis”; Udhëzimi i Ministrisë të Mjedisit nr.1,datë 19.02.2018 “Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat”; VKB nr.22,date 18.04.2019 për miratimin e “Planit Lokal për veprimin e zhurmës në mjedis” dhe sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër nr _____ prot, datë _____

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e VKB nr. 22, date 18.04.2019 ‘Për miratimin e “Planit lokal për veprimin e zhurmës në mjedis” të Bashkisë Shkodër, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Zv.Kryetar

KRYETAR
BARDH SPAHIA



Drejtorja e mjedisit, pyjeve dhe administrimit të ujërave

Arta Shkollaku

Drejtorja Juridike

Ol



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE

Nr. _____ prot

Datë ____ . ____ .2022

RELACION
PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 22, DATE 18.04.2019 PËR MIRATIMIN E
“PLANIT LOKAL PËR VEPRIMIN E ZHURMËS NË MJEDIS” TË BASHKISË
SHKODËR”

(Miratimin e përditësimit të hartës së zonave të qeta dhe zonave me aktivitet të shërbimit social dhe kulturor.)

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, në fushën e mbrojtjes së mjedisit bazuar në nenin nr 26 të ligjit nr 139/2015 “ Për vetqeverisjen vendore” në përmbushje të kërkesave dhe standarteve të parashikuara në pikën 2 neni 8 i Ligjit nr 9774/2007 “ Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis”, nenit 22, të Ligjit nr 10431/2011 “ Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar , VKM nr 123 datë 17.02.2011 “ Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis” si edhe Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr 1 datë 19.02.2018 “ Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat”, ka miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr 22 dt 18.04.2019“ Planin Lokal për veprimin e zhurmës në mjedis”.

Ky plan shoqërohet me Tabelën e Aktiviteteve që propozohen si edhe me Planin e Veprimit. Pika 6 dhe 7 e Planit të Veprimit parashikon :

Vlerësimin dhe përditësimin e Zonave të Qeta si edhe Rishikimin e Hartës së Zhurmave për Aktivitet e shërbimit Social dhe kulturor.

Aktivitete këto të parashikuara për tu realizuar sipas Planit të Veprimit në këtë vit. Përtej detyrimit për zbatimin e Planit të Veprimit , situata ndryshon edhe për shkak të vendimeve apo orjentimeve që vijnë nga institucionet qëndrore. Neni 10 i VKM nr 171/2019 “ Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë në stacionet e plazhit “shprehimisht thotët : “ Cdo stacion plazhi është i detyruar të respektojë nivelin kufi të zhurmave të parashikuara në aktet nënligjore në fuqi për zhurmat si dhe /ose Planet Vendore të miratuara nga organet e vetqeverisjes vendore” . Per kete arësyje kemi realizuar

pikërisht përditësimin e Hartës së Zonave të qeta si edhe hartëzimin me oraret e përcaktuara për aktivitetet e shërbimit social dhe kulturor,

Ky material do të paraqesë Hartëzimin e zonave ku do të aplikohen standartet minimale të kërkuara për veprimtarinë e zhurmave në mjedis të komponentit 3. Aktivitetet e shërbimit social dhe kulturor si klube nate, bare restorante, disko etj.

Përditësim i hartës dhe të dhënave të Planit Lokal të Veprimit të Zhurmës (fq 26) I miratuar nga Këshilli i Bashkisë me Vendim nr 22 dt 18.04.2019 është bërë në hartën bashkelidhur materialit ku në këtë klasë bëjnë pjesë zonat në të cilat qetësia është pjesë e rëndësishme e përdorimit të saj si: zonat e mbrojtura natyrore, zonat e shërbimeve publike si zonat spitalore, kopshtet, shkollat 9-vjecare, shkollat e mesme. zonat e destinuara për qëllime pushimi, zonat rezidenciale rurale, parqet publike etj


Në zonat urbane dhe kryesisht në qendrat turistike, një ndër burimet kryesore të ndotjes akustike është edhe sektori i shërbimeve sociale që përfshin baret, restorantet klubet e natës diskot etj. Bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr 1 datë 19.02.2018 “ Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat”, kreu IV , Aktivitetet e shërbimit social dhe kulturor , në Aktin Normativ nr 2 /2012 “Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të menjëherëshme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare” është bërë përditësimi i hartës, dhe orareve sipas hartës bashkelidhur.

Të nderuar Këshilltarë !

Mbështetur në nenin 93 pika 2 të ligjit nr 139/2015 “ Për vetqeverisjen vendore” I ndryshuar, neni 8 i Ligjit nr 9774/2007 “ Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis”, nenit 22 të Ligjit nr 10431/2011 “ Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar , VKM nr 123 datë 17.02.2011 “ Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis” si edhe Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr 1 datë 19.02.2018 “ Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr 22 dt 18.04.2019 për miratimin e “ Planit Lokal për veprimin e zhurmës në mjedis”.

ju ftomë në vlerësimin e dakortësisë për Miratimin e njw ndryshimi nw “**VKB nr. 22, date 18.04.2019 për miratimin e “Planit lokal për veprimin e zhurmës në mjedis” të Bashkisë Shkodër .**

Konc: Erkam Borici
Pranoi : Aida Shllaku
Miratoi : Zv/Kryetar Tonin DEDAJ





BASHKIA
SHKODËR

www.bashkiashkoder.gov.al

VLERËSIMI DHE PËRDITËSIMI I HARTËS SË ZONAVE TË QETA

DHE ZONAVE ME AKTIVITET TË SHERBIMIT SOCIAL DHE KULTUROR

Për një ndryshim në VKB nr. 22 datë 18.04.2019 për
miratimin e “Planit Lokal për veprimin e zhurmës në
mjedis”.

Hyrje

Bashkia Shkodër në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, në fushën e mbrojtjes së mjedisit bazuar në nenin nr 26 të ligjit nr 139/2015 “ Për vetqeverisjen vendore” në përmbushje të kërkesave dhe standarteve të parashikuara në pikën 2 neni 8 i Ligjit nr 9774/2007 “ Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis”, nenit 22,23 të Ligjit nr 10431/2011 “ Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar , VKM nr 123 datë 17.02.2011 “ Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis” si edhe Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr 1 datë 19.02.2018 “ Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat”, ka miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr 22 dt 18.04.2019 “ Planin Lokal për veprimin e zhurmës në mjedis”.

Ky plan shoqërohet me Tabelën e Aktiviteteve që propozohen si edhe me Planin e Veprimit. Pika 6 dhe 7 e Planit të Veprimit parashikon :

Vlerësimin dhe përditësimin e Zonave të Qeta si edhe Rishikimin e Hartës së Zhurmave për Aktivitetet e shërbimit Social dhe kulturor.

Aktivitete këto të parashikuara për tu realizuar sipas Planit të Veprimit në këtë vit. Përtej detyrimit për zbatimin e Planit të Veprimit , situata ndryshon edhe për shkak të vendimeve apo orjentimeve që vijnë nga institucionet qendrore. Neni 10 i VKM nr 171/2019 “ Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë në stacionet e plazhit “shprehimisht thotët : “ Cdo stacion plazhi është i detyruar të respektojë nivelin kufi të zhurmave të parashikuara në aktet nënligjore në fuqi për zhurmat si dhe /ose Planet Vendore të miratuara nga organet e vetqeverisjes vendore” .

Ky material do të paraqesë Hartëzimin e zonave ku do të aplikohen standartet minimale të kërkuara për veprimtarinë e zhurmave në mjedis të komponentit 3. Aktivitetet e shërbimit social dhe kulturor si klube nate, bare restorante, disko etj.

Reagimi i popullsisë ndaj zhurmave

Zhurma që hyn në ambjentet jetësore (nga ana e mjeteve të transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror , industrial dhe aktiviteteve sociale) rrallëherë arrin nivele të tilla që të sjellë rrezik serioz të aparatit dëgjimor. Porse, shumë më të shpeshta janë mundësitë e konstatimit të efekteve extradëgjimore të zhurmave mbi shëndetin sic pranohet edhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) përse i përket gjendjes së mirëqenies fizike, mendore dhe sociale. ¹

Këto efekte, nuk janë të shpërndara në mënyre uniforme në popullsi, por janë më të dukshme në grupmoshat me ndjeshmëri më të lartë, si pleqtë, fëmijët dhe të sëmurët.

Shumë nga efektet extradëgjimore të shkaktuara nga zhurmat përfshihen në dinamikën e stresit dhe kushtëzohen nga sjellja psikologjike e individit, si dhe nga aftësia e përshtatjes së

¹ EEA. “ Good practice guide on noise exposure and potential health effects”, European Environment Agency, 2010.

organizmit. Rrjedhimisht që, në formimin e këtyre efekteve luajnë rol shumë faktorë, që mund të mos jenë detyruesisht të lidhur me karakteristikat fizike të zhurmave.

Kështu karakteristikat personale të individit, ndjeshmëria e tij ndaj zhurmave, motivimi i tij bëjnë që të përcaktojnë edhe raportin e tij me burimin e zhurmës. Vërejmë se tolerimi ndaj një zhurme është më i madh atëherë kur individ është shkaktar i zhurmës apo në rastet kur individ është i aftë ta kontrollojë atë.²

Përsa i përket mjedisit rrethues, faktori kryesor është izolimi akustik i ndërtesës. Kjo jo vetëm si aftësi fonoizoluese e saj, por edhe në lidhje me prezencën e impianteve të kondicionimit të ajrit, të orientimit të ambienteve akustikisht të ndjeshme (dhoma gjumi) ndaj burimit të zhurmës, të kushteve klimatike që ndikojnë mbi aftësinë fonoizoluese (dritare të hapura) dhe/ose të kryerjes së aktiviteteve jashtë godinave (oborr etj).

Në përgjithësi, kushteve me izolim të mirë akustik i përgjigjen reagime më të vogla të bezdisë nga zhurmat.

Një nga pikat e rëndësishme është dhe Efektet sociale dhe ekonomike të ndikimit të zhurmës.

Efektet sociale të zhurmave mund ti përcaktojmë në sasi, pasi toleranca e njerëzve ndaj nivelit të zhurmave dhe tipeve të ndryshme të zhurmave, është e ndryshme, por arrijmë të vlerësojmë se impakti social i zhurmave është i madh; në grupet e ndjeshme të cilët meritojnë një vëmendje të veçantë si fëmijët, të moshuarit, dhe të sëmurët.

Zhurmat mjedisore kanë përfshirje gjithashtu edhe në kostot dhe përfitimet në ekonomi në përgjithësi. Psh, efekti kosto është i njohur: në degradimin e zonave të banuara shumë të ekspozuara ndaj zhurmave ambientale.³

Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr 8 datë 27.11.2007 “ Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, përcakton Nivelet kufi të zhurmës për mjedise të caktuara referuar vlerave udhëzuese të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH).

Si mjedise të caktuara, për efekt të zbatimit të këtij udhëzimi, janë identifikuar mjediset e zonave të banimit, (jashtë banesës, mjediset e brendshme të banesës), institucionet (arsimore, parashkollore e shëndetësore), zona me aktivitet social-ekonomik, mjedise urbane dhe parqet publike.

Nisur nga sa më sipër kemi përcaktuar për secilën klasë përdorimi të territorit edhe nivelin e emetimit të zhurmës, nivel ky max i lejuar referuar dispozitave ligjore, ku LAeq është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik të ponderuar (A0), prodhuar nga të gjitha burimet e zhurmave që ekzistojnë në një vend të caktuar dhe gjatë një kohe të caktuar. Referuar përcaktimeve të OBSH të dhënat LAeq e janë si më poshtë:

² EEA. “ Good practice guide on noise exposure and potential health effects”, European Environment Agency, 2010.

³ Doktoratura L.Aleksis

Klasa e Përdorimit të territorit.	Koha bazë –dita 06:00-22:00	Koha bazë Nata 22:00-06:00
I. Zona vecanërisht mbrojtur.	50	40
II. Zonat rezidenciale.	55	45
III. Zona të përziera.	60	50
IV. Zona me aktivitet njerëzor intensiv	65	55
V. Zona industriale	70	60

Klasa	Përdorimi i territorit
I	Zonë vecanërisht mbrojtur: në këtë klasë bëjnë pjesë zona në të cilat qetësia është pjesë e rëndësishme e përdorimit të saj si: zonat e mbrojtura natyrore, zonat e shërbimeve publike si zonat spitalore, kopshtet, shkollat 9-vjecare, shkollat e mesme, zonat e destinuar për qëllime pushimi, zonat rezidenciale rurale, parqet publike etj
II	Zonat rezidenciale: në këtë klasë bëjnë pjesë zona urbane me dendësi mesatare dhe të ulët të popullsisë banuese, ku trafiku është kryesisht lokal dhe me prezencë të ulët të aktivitetëve komerciale dhe pa aktivitet industrial.
III	Zona të përziera: Bëjnë pjesë në këtë klasë zonat urbane me trafik rrugor lokal ose ndërqytetar, me densitet mesatar të popullatës, me prezencë të aktivitetëve tregtare, zyra, aktivitete artizanale, dhe mungesë të aktivitetëve industriale.
IV	Zona me aktivitet njerëzor intensiv: Bëjnë pjesë në këtë klasë zonat urbane me trafik rrugor intensiv, me densitet shumë të lartë të popullatës, me prezencë të lartë të aktivitetëve tregtare të shërbimit social dhe kulturor si klube nate, bare, restorante e disko, me prezencë të aktivitetëve artizanale; zonat në afërsi të rrugëve të mëdha apo linjave hekurudhore; zonat portuale apo zona me prezencë të limituar të industrive
V	Zona kryesisht industriale: Bëjnë pjesë në këtë klasë zonat me aktivitet të theksuar industrial me përqindje të vogël të ndërtesave për banim.

Bazuar në sa më sipër në Aneksin 1 (bashkëlidhur) është paraqitur **HARTA E ZONAVE TË QETA**, ky është përditësim i hartës dhe të dhënave të Planit Lokal të Veprimit të Zhurmës (fq 26) i miratuar nga Këshilli i Bashkisë me Vendim nr 22 dt 18.04.2019.

Kjo hartë përfshin Klasën I të përdorimit të territorit, e klasifikuar sipas dispozitave ligjore edhe në Planin Lokal të Veprimit të Zhurmës në mjedis, si Zonë vecanërisht e mbrojtur ku bëjnë pjesë zona në të cilat qetësia është pjesë e rëndësishme e përdorimit të saj si: zonat e mbrojtura natyrore, zonat e shërbimeve publike si zonat spitalore, kopshtet, shkollat 9-vjecare, shkollat e mesme zonat e destinuar për qëllime pushimi, zonat rezidenciale rurale, parqet publike etj

Vëmendja ndaj problemit të ndotjes akustike në qytetet shqiptare është rritur ndjeshëm si pasojë e dispozitave të rëndësishme ligjore të lëshuara vitet e fundit. Në vecanti, Ligji

Nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, vendosi në themel të reduktimit të dëmeve ambientale si pasojë e ndotjes urbane nga zhurmat, redaktimin dhe zbatimin e planit kombëtar dhe më pas, planeve lokale të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis.

Në Planin e miratuar është theksuar se një nga **Burimet e zhurmës që lidhen me ndotjen akustike të territorit është:**

- Burimet që vijnë nga ambientet tregëtare , ambiente zbavitëse (klube nate, bare , restorante disko etj) .

Objektivi kryesor është menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

Të bësh një qytet të jetueshëm nga pikpamja ambientale në përgjithësi, dhe akustike në vecanti, sot përbën një nga sfidat kryesore të një qeverie vendore të suksesshme.

Në zonat urbane dhe kryesisht në qendrat turistike, një ndër burimet kryesore të ndotjes akustike është edhe sektori i shërbimeve sociale që përfshin baret, restorantet klubet e natës diskot etj .

Aktualisht vetëm në qytetin e Shkodrës dhe zonën turistike të Velipojës ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 198 subjekte ne sektorin e shërbimeve sociale ku përfshihen bar-kafe dhe restorante disko etj. (Harta e Zonimit të Zhurmave në territor pika 3 fq 63 e Planit Lokal të Veprimit të Zhurmës në Mjedis).

Bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr 1 datë 19.02.2018 “ Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat”, kreu IV , **Aktivitetet e shërbimit social dhe kulturor** , në Aktin Normativ nr 2 /2012 “Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të menjëherëshme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në **qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare**” është bërë përditësimi i hartës (Aneksi 2) dhe nisur nga fakti që zhurma është ajo që detyron institucionet publike që bazuar në dispozitat ligjore, të marrin masat, për të vlerësuar nivelin e ndotjes nga zhurma , parandalimin kontrollin dhe mbrojtjen e shëndetit publik , Propozojmë që :

Zona turistike/ bregdetare e Velipojës

Kjo zonë ndahet në 3 zona:

-ZONA 1 , përfshin kryesisht Zonën urbane të Plazhit të Velipojës , zonën ku janë të përqëndruara hotelet, shtëpitë e pushimit apo edhe shtëpitë e dyta , e cila kufizohet :

Rruga Nr 1 , rruga Shkodër-Velipojë , Rruga Shtëpia e Peshkatarit dhe Shetitorja këmbësore (Pedonale) . (Harta 1 pjesë e Aneksit 2).

Të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet muzikor që gjenerojnë zhurmë në mjedis (disko , bar resorant me muzikë live etj) do të lejohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas orarit të përcaktuar në Aktin Normativ nr 2 /2012 “Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të

menjëherëshme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare” :

Ditët e javës në orarin 19.00-23.30

Ditët e premte dhe të shtunë në orarin 19.00-24.00

ZONA 2 përfshin të gjitha strukturat e Stacioneve të Plazhit (beach-bar) të cilat ndodhen në pjesën ranore përtej Shetitores këmbësore(pedonale) (harta 2 pjesë e Aneksit 2).

Të gjitha strukturat e plazhit (beach bar) të cilat dëshirojnë të zhvillojnë aktivitet muzikor pra që gjenerojnë zhurmë mjedisore orari do të jetë :

Ditët e javës prej orës 19.00- 24.00

Ditën e premte dhe të shtunë prej orës 19.00-1.00

ZONA 3 përfshin zonën e plazhit të Vilunit dhe zonën e Plazhit të Rrjollit. (Harta 3 pjesë e Aneksit 2)

Kjo zonë nisur nga fakti që është larg zonave të banuara dhe hotelierisë për të gjitha subjektet që dëshirojnë të ushtrojnë aktivitet muzikor pra që gjenerojnë zhurmë mjedisore , orari I Zhvillimit të këtyre aktiviteteve do të jetë:

Ditët e javës prej orës 19.00-24.00

Ditën e premte dhe të shtunë prej orës 19.00-3.00

Qyteti i Shkodrës.

Në Zonën Urbane të Qytetit të Shkodrës , Të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet muzikor që gjenerojnë zhurmë në mjedis (disko , bar resorant me muzikë live etj) do të lejohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas orarit të përcaktuar në Aktin Normativ nr 2 /2012 “Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të menjëherëshme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare” :

Ditët e javës në orarin 19.00-23.30

Ditët e premte dhe të shtunë në orarin 19.00-24.00

Pjesë e zonës urbane të qytetit të Shkodrës është edhe ZONA BID (Business Improvement District) e cila rregullon marrëdhëniet e saj bazuar në Ligjin nr 63/2022 “ Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)”. Për sa nuk bie ndesh me këtë ligj , edhe për këtë zonë të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet muzikor që gjenerojnë zhurmë në mjedis (disko , bar resorant me muzikë live etj) do të zbatohet orari i përcaktuar në Aktin Normativ nr 2 /2012 “Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të menjëherëshme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare” :

Ditët e javës në orarin 19.00-23.30

Ditët e premte dhe të shtunë në orarin 19.00-24.00

Për aktivitete të cilët zhvillohen nga Bashkia Shkodër ose partneritet me Bashkinë Shkodër , Institucione , NGO etj , aktivitete të zhvilluara në ambiente të mbyllura ose të hapura si sheshe/rrugë publike etj , miratimi i orarit të zhvillimit të tyre do të bëhet rast mbas rasti sipas vlerësimit që do të bëhet edhe me drejtoritë përkatëse të Bashkisë Shkodër.

Zona Turistike Shirokë-Zogaj.

Kjo zonë ndahet në dy zona:

ZONA 1. Zona Urbane Shirokë Zogaj . Të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet muzikor që gjenerojnë zhurmë në mjedis (disko , bar resorant me muzikë live etj) do të lejohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas orarit të përcaktuar në Aktin Normativ nr 2 /2012 “Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të menjëherëshme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare” :

Ditët e javës në orarin 19.00-23.30

Ditët e premte dhe të shtunë në orarin 19.00-24.00

ZONA 2. Zona jashte zonës urbane .

Kjo zonë nisur nga fakti që është larg zonave të banuara dhe hotelerisë për të gjitha subjektet që dëshirojnë të ushtrojnë aktivitet muzikor pra që gjenerojnë zhurmë mjedisore , orari i Zhvillimit të këtyre aktiviteteve do të jetë:

Ditët e javës prej orës 19.00-24.00

Ditën e premte dhe të shtunë prej orës 19.00-1.00

ANEKSI 1 : “Harta e zonave të qeta urbane”



ANEKSI 2. Harta e aktiviteteve të shërbimit social dhe kulturor.

Oraret e lejuara të zhurmave në mjedis.




Harta 1. Zona 1: Zona urbane të Plazhit të Velipojës




Harta 2. Zona 2: Strukturat e Stacioneve të Plazhit (beach-bar) të cilat ndodhen në pjesën ranore përtej Shetitores këmbësore(pedonale)



Harta 3. Zona 3: Plazhi i Vilunit dhe zonën e Plazhit të Rrjollit



Harta 4. Zona urbane ne zonën turistike Shiroke



Harta 4. Zona urbane ne zonën turistike Zogaj